

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit BSc “Infermieri e Përgjithshme”

ofruar nga Universiteti Aldent

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof.Asc.Dr. Manika KREKA (FACE)

Dr. Brizida REFATLLARI (FURXHI)

Shkurt 2017

Draft - RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit BSc në “Infermieri e Përgjithshme”

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Aldent
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Mjekësore
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr 794, dt 22.07.2009
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	UMAS Nr 240, dt 26.05.2011
5	Titulli i programit të studimit:	Bsc në “Infermieri e përgjithshme”
6	Cikli i studimit:	I parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6 (gjashtë)
16	Aktivizimi i programit të studimit	UMASH Nr 448, dt 05.10.2010
17	Numri i studentëve për këtë program	803 studentë që nga viti akademik 2011-2012 deri më tani

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Infermieri të Përgjithshme

Universiteti Aldent ka në përbërjen e tij dy Fakultete dhe katër Departamente, njëri prej të cilave është Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë. Programi i Studimit Bachelor në Infermieri të Përgjithshme i ciklit të parë është licencuar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr.794, datë 22.07.2009 (3 vite akademike). Ky program është konsoliduar ndër vite dhe në vitin 2011 (26.05.2011) kaloi akreditimin e parë me urdhër 240. Janë mbushur 6 vjet nga ky proces dhe tashmë me vullnet të lirë, pasi kërkoi të riakreditohej iu dha e drejta për fillimin e këtij procesi në 27.10.2016, me Nr. 201/1 nga APPAL.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof.Asc.Dr.Manika Kreka(Face)
2. Dr. Brizida Refatllari (Furxhi)

Draft raporti i vlerësimit të jashtëm është dërguar në Institucion më datë 13.02.2017. Nga Universiteti Aldent vjen shkresa me Nr 47/4 prot, datë 22.02.2017 “Kthim përgjigje në lidhje me RVJ-Draft, “Bachelor” në “Infermieri e Përgjithshme”. Ekspertet e Vlerësimit të Jashtëm, pasi lexuan komentet e Institucionit, morën parasysh këto komente të UA duke bërë ndryshimet në raportin përfundimtar. U bënë ndryshimet në pikën 3 - Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit, si dhe emërtimi i Aneksit 2, Tabela 2 - Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK). Gjithashtu u ndryshuan edhe disa paragrafe që kanë lidhje me syllabuset (faqe 17 dhe 18 të raportit)

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Personeli pedagogjik të krijojë kushte që të motivojë dhe të nxitë studentët për rritjen e cilësisë së rezultateve.
- b) Të nxitin dhe mbështeten nga i gjithë personeli drejtues dhe pedagogjik studentët për një studim sistematik që do të çonte pa dyshim në rritjen e rezultateve të tyre.
- c) Drejtuesit e institucionit të rritin kërkesat për rritjen e nivelit të kërkimit shkencor si nga personeli akademik ashtu edhe nga studentët.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin e parë, në lidhje me krijimin e kushteve për të nxitur studentët në drejtim të rritjes së cilësisë së rezultateve, institucioni ka ndërmarrë disa veprime e ndër to më i rëndësishmi është përmirësimi i infrastrukturës duke e zhvendosur Departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë në një godinë të re me sipërfaqe 5000 m², me auditore të mirëpajisura me laboratore dhe atelie. Një bibliotekë e pasur me larmi librash mbi 3000 tituj librash në shqip dhe gjuhë të huaj u vjen në ndihmë studentëve. Po kështu edhe mjedise që nxitin kreativitetin dhe ndihmojnë në uljen e stresit.
- b) Për rekomandimin e dytë, në lidhje me nxitjen dhe mbështetjen e studentëve nga i gjithë stafi drejtues e pedagogjik për një studim sistematik të vazhduar që do të çonte në rritjen e cilësisë së rezultateve, institucioni ka ndërmarrë mjaft masa didaktike duke përfshirë orë interaktive me detyra kursi e projekte në shumicën e lëndëve. Sigurisht këto lëndë në auditore të kombinuara me orët e praktikave profesionale në spitale e kanë bërë studentin në mbarim të studimeve, më të aftë për t'u përballuar në jetë me vështirësitë e profesionit të tyre. Studentët janë ndihmuar gjithashtu me shërbimin e kujdestarisë akademike (tutoriatit), pra ata kanë një pedagog kujdestar, i cili i ndihmon, i sqaron dhe ndan me ta problematika të jetës shkollore - akademike, duke i këshilluar apo mbështetur për një

- edukim më të mirë dhe më cilësor. Nga bisedat me studentët, kjo gjë u evidentua dhe u shprehën entuziastë për këtë risi.
- c) Për rekomandimin e tretë në lidhje me shtimin e kërkesave të drejtuesve të institucionit për rritjen e nivelit të kërkimit shkencor, si nga personeli akademik, ashtu edhe nga studentët, institucioni ka mbështetur studentët dhe stafin pedagogjik duke inkurajuar për të bërë botime të ndryshme në revista si brenda, ashtu edhe jashtë vendit, pjesëmarrje në konferenca etj. Është krijuar një qendër për Kërkimin Farmakoterapeutik, me stafin e duhur, edhe me infrastrukturën optimale, por sigurisht duhet të funksionojë/prodhojë projekte të kërkimit shkencor duke përfshirë studentë e pedagogë. Dhe kjo u premtua se do të intensifikohej.
- Ka filluar të organizohet një Konferencë Shkencore Studentore (e planifikuar cdo vit akademik). Konferenca e parë u mbajt në Qershor 2016, e cila do të përsëritet edhe këtë vit akademik. Studentët do të prezantojnë punën e tyre shkencore nën tutoriatin e pedagogëve përkatës të fushës infermieristike.



ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Mësimdhënia është një proces i rëndësishëm i jetës akademike. Synimi për të aftësuar studentët, me nocionet bazë të fushës, përcjellja e njohurive teorike dhe praktike janë në themel të mësimdhënies. Ka përpjekje për kërkimin shkencor, sidomos në lëndët paraklinike duke ofruar mbështetje laboratorike nga IAL, Universiteti Aldent. Vetë studentët do të përfshihen duke bërë matje funksionale për njëri-tjetrin në laboratoret përkatëse. IAL me bazën didaktike që ofron si edhe me burimet njerëzore (të trajnuar jashtë dhe brenda vendit në fushën e Infermierisë dhe Fizioterapisë) përbën potencial të rëndësishëm në këtë fushë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Infermiera është një fushë në zhvillim dhe si e tillë kërkon përpjekje të pandalshme nga ekipi që edukon infermierët e së nesërme. I tillë është edhe ky ekip i IAL Aldent, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë.</p> <p>Me programe të përditësuara përpiqet të edukojë infermierë të aftë të mbështesin dhe ndihmojnë popullatën duke asistuar në ndërhyrjet infermiore në sëmundje të caktuara, si edhe në aktivitetin parandalues për sëmundje problematike për shëndetin publik të popullatës. Dijet jepen në bazë të programeve të detajuara. Tregu i punës ka nevojë për infermierë dhe për këtë shërben një përditësim i vazhdueshëm i programit mësimor, duke aftësuar studentët për të qenë të aftë të punojnë si brenda edhe jashtë vendit.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Aplikimi i njohurive të fituara në funksion të shërbimit ndaj pacientëve duket se është prioritet i këtij institucioni. Në këtë program, studenti aftësohet me njohuritë fillestare të formimit të një infermieri, duke i pasuruar më vonë me studime më të thelluara. Institucioni i mbështet duke iu krijuar kushte aplikative si brenda dhe jashtë tij. Studentët shfaqin kënaqësi duke demonstruar potenciale aftësish në menaxhimin e situatave klinike e terapeutike.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Para fillimit të çdo viti akademik, hartohet strategjia e parashikimit të nevojave për rekrutimin e studentëve (nga 33 studentë në 2011- 2012, në 111 studentë të regjistruar në 2016-2017). Duket se në vite ka një shtim të rëndësishëm të këtyre nevojave dhe për këtë arsye, numri i studentëve ka qenë në rritje. Është kalkuluar mirë ky numër dhe në përputhje me nevojat vendase dhe parashikimit për të plotësuar synimet e të rinjve për të emigruar është ofruar infrastruktura njerëzore dhe hapësinore. Është synuar pajisja e studentëve me njohuritë bazë që do t'i ndihmojnë ata të hyjnë në botën humane të infermieristikës. Jeta profesionale e infermierit është e mbushur me humanizëm, përgjegjshmëri dhe profesionalizëm të lartë e për këtë ata kërkojnë një trajnim të mirëpërcaktuar, kjo duket se ofrohet në UAL.</p>
Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	

<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Institucioni ofron norma etike, morale , manifeston kulturë e histori të dukshme. Studentët mbartin vlera të veçanta komunikimi dhe kjo doli edhe në intervistat dhe bisedën e lirë që patëm me ta.</p>
<p>Konkluzione të GVJ:</p> <p>Ky program studimi i ciklit të parë të Infermierisë së Përgjithshme mbart informacion të mirë, të detajuar e me vlera shkencore në dobi të formimit profesional të infermierëve. Lëndë të rëndësishme të formimit bazë si Fiziologjia, Anatomia e njeriut, Histologjia, Biologjia, etj, i plotësojnë më së miri me njohuritë e tyre në funksion të thellimit të njohurive në lëndët klinike në vitet e ardhshme. Instituti harton strategji të parashikimit të rekrutimit të studentëve në varësi të kërkesave të tregut të punës.</p>	

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Fakulteti i Shkencave Mjekësore, në përbërjen e të cilës ka dy Departamente dhe një qendër kërkimore, të cilët funksionojnë në harmoni. Përgjegjësi i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë mban titullin Profesor i asociuar. Ai është drejtues i Departamentit dhe emërohet në këtë detyrë nga Rektori me pëlqimin e Dekanit dhe të Presidentit të UAL. Ndarja dhe planifikimi i ngarkesës mësimore është kompetencë e tij. Përgjegjësi i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë ka përmbushur në vazhdimësi kompetencat dhe detyrat për të organizuar punën në departament.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit
- Organet e zgjedhura në të gjitha nivelet
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Një nga Fakultetet e Universitetit Aldent është Fakulteti i Shkencave Mjekësore. Ky Fakultet si njësi kryesore bashkërendon mësimdhënien me kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha të përafërta. Fakulteti i Shkencave Mjekësore është i ndërtuar nga Departamenti i Farmacisë, Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë dhe Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike. Përgjegjësi i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë mban titullin Profesor i asociuar. Ai është drejtues i Departamentit dhe emërohet në këtë detyrë nga Rektori me pëlqimin e Dekanit dhe të Presidentit të UAL. Ndarja dhe planifikimi i ngarkesës mësimore është kompetencë e tij. Përgjegjësi i Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë ka përmbushur në vazhdimësi kompetencat dhe detyrat për të organizuar punën në departament. Ka organizuar vlerësimin e brendshëm në departament duke kryer edhe vlerësimin e performancës së aktivitetit shkencor-mësimdhënës e akademik.

Programi mësimor i kërkuar na u ofrua. Kurrikula e ciklit të parë programi Infermieri e Përgjithshme ishte e dizenuar mjaft mirë, në lëndë e module. Sigurisht që vazhdimisht lind nevoja për përditësimin e syllabuseve.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Fakulteti i Shkencave Mjekësore është Fakulteti përgjegjës për Programin Bachelor, Infermieri e Përgjithshme. Nga të dhënat në RVB rezulton se numri i Personelit Akademik në këtë departament është 10 PAE dhe 33 PAK. Nga personeli i pedagogëve efektivë 3 janë me grada e tituj.

Sipas RVB, në programin e studimit Bsc Infermieri e Përgjithshme, mbështetur në planin mësimor, rezulton se janë angazhuar në mësimdhënie gjithsej 15 PAE, nga të cilët 5 pedagogë janë me tituj/grada dhe 15 PAK, nga të cilët 6 pedagogë janë me tituj/grada.

Rezultoni se stafi akademik i brendshëm përbën 50% të numrit të stafit akademik të angazhuar si mësimdhënës në këtë program studimi. Nga plani mësimor dhe nga angazhimi real i stafit akademik rezulton se stafi akademik i brendshëm mbulon 83% të ngarkesës në orë mësimore. Raporti pedagog/student për vitin 2016-2017 është 1/8,5 (ka ardhur në rritje

nga 1/2 për vitin 2012-2013). Kriteret e punësimit dhe rekrutimit të pedagogëve të rinj janë bërë konform rregullave.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura didaktike (seksionet) për departamentet ose programin e studimit
Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë përbëhet nga 10 pedagogë PAE dhe 33 pedagogë PAK.
Gjatë vizitës në institucion, u deklarua nga drejtuesit e institucionit por edhe të Departamentit se në Programin e studimit Infermieri e Përgjithshme, aktualisht janë të angazhuar 15 pedagogë si PAE dhe 15 pedagogë si PAK
- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat.
Nga personeli i pedagogëve efektivë ne departament 3 janë me grada e tituj dhe 13 janë me grada e tituj si PAK. Është për t'u theksuar se lëndët infermieristike dhe rehabilituese në departamentin e Infermieristikës dhe Fizioterapisë lektohen nga pedagogë me eksperiencë dhe të specializuar në fushat përkatëse, pasi ende nuk ka kuota për studime të ciklit të tretë për këto specialitete.
- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre
Kualifikimet e pedagogëve janë duke filluar nga specializime afatgjata, deri në titullin Profesor i Asociuar.
- Të dhënat sipas seksit
Ka një ekulibër midis dy seksëve, gërshetim optimal të femrave dhe meshkujve. Vihet re dukshëm një harmoni në komunikim në të mirë të punës dhe mësimdhënies në veçanti.
- Të dhëna sipas moshës së personelit
Personeli me tituj e grada është mbi moshën 50 vjeç. Ka edhe personel më të ri, i cili është në procesin e marrjes të gradës "Doktor".
- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat
Nga kontratat e punës që pamë, vumë re se është respektuar mjaft mirë kodi i punës dhe ka specifikime për çdo individ të rekrutuar.
- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë
Mjaft e mirë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Nevoja për personel akademik me kohë të plotë (PAE) përcaktohet pas kalkulimeve të ngarkesës nga Përgjegjësi i Departamentit dhe konform rregullave, ai ia parashtron kriteret bazë për rekrutim Senatit të Universitetit. Më pas ngrihet komisioni sipas procedurës.</p> <p>Rezulton se stafi akademik i brendshëm përbën 50% të numrit të stafit akademik të angazhuar si mësimdhënës në këtë program studimi, por stafi i brendshëm prej 15 pedagogësh angazhohet dhe mbulon 83% të ngarkesës në orë mësimore.</p> <p>U njohëm me një praktikë rekrutimi të kryer në fillim të vitit akademik 2016-2017 dhe tabelën përkatëse, e cila përmbush kriteret e punësimit të një PAE. Zyra e Burimeve Njerëzore na tregoi dosjet e ruajtuara gjatë këtij procesi. Shpallja e fituesit ishte bërë sipas rregullave të përcaktuara më parë.</p>

Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore "Doktor, ose titullin akademik "Docent,.</p>	<p>Dosjet e kërkuara për t'u verifikuar për pedagogë me kohë të plotë dhe me kontratë, na u vunë në dispozicion. Dosjet përmbanin dokumentacionin bazë, me përjashtim të dy rasteve ku mungonin lista e notave e ciklit të parë të studimeve.</p> <p>Pedagogët titullarë të lëndëve kanë gradën/titullin përkatës. U njohëm me listën e plotë të PAE dhe PAK ku vihet re konkordancë me tabelat e paraqitura në RVB dhe në anekset përkatëse. Pedagogët ofrojnë një eksperiencë të madhe në mësimdhënie dhe në praktikë klinike. Ka një ndërthurje të bukur midis brezave dhe harmoni në transmetimin e eksperiencës, gjë që u pa edhe në takimet tona.</p>
Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentët).</p>	<p>Praktikat laboratorike organizohen plotësisht sipas programit kurrikular në mjediset e Fakultetit, duke angazhuar studentët të punojnë të pavarur në ateli të infermierore dhe në laboratorët e anatomisë, fiziologjisë, histologjisë dhe anatomo-patologjisë . Puna me manekinë, me mulazhe është mjaft e evidente, duke qenë fillesë e punës në klinika. Ata shoqërohen dhe drejtohen nga pedagogët e tyre të Fakultetit, që në shumë raste kanë edhe tutorë dhe më pas lidhen me infermieret referente që angazhohen në orientimin e tyre në pavione e spitale. Raporti 1 tutor për 12 studentë është optimal në sigurimin e përfuturit të njohurive.</p>
Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Institucioni ka organizuar në vite seminare, workshop-e, leksione të hapura, të gjitha këto në funksion të rritjes së kapaciteteve të personelit akademik dhe studentëve. Pedagogë vendas e të huaj kanë qenë trajnerë dhe kanë ofruar eksperiencën e tyre, kjo falë bashkëpunimeve me Institucione jashtë vendit, ISHP, UMT etj. Shumë foto, fletëpalosje dhe materiale informative të vëna në dispozicion për të gjithë e dëshmojnë këtë. Së fundmi, institucioni ka dhënë miratimin, për mundësimin e një trajnimit afatgjatë të një pedagogjeje jashtë Shqipërisë, në drejtimin fizioterapi.</p>
<p>Konkluzione të GVJ:</p> <p>Vërehen procedura të sakta ligjore rekrutimi, me transparencë të lartë, rigorozitet dhe mençuri. Rezulton se stafi akademik i brendshëm përbën 50% të numrit të stafit akademik të angazhuar si mësimdhënës në këtë program studimi, por stafi i brendshëm prej 15 pedagogësh angazhohet dhe mbulon 83% të ngarkesës në orë mësimore.</p> <p>Pedagogët ofrojnë eksperiencë në mësimdhënie dhe në praktikën klinike, ku vihet re një ndërthurje e bukur midis brezave dhe harmoni në transmetimin e eksperiencës. Kontratat e punës të vëna në dispozicion e reflektojnë më së miri seriozitetin e këtij Institucioni.</p>	

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Mjediset e Universitetit Aldent (me të cilat ishim njohur që në RVB) janë të përshtatshme për studentët dhe të gjithë personelin akademik dhe joakademik. Të gjitha mjediset duket qartë se janë në funksion të shërbimit ndaj studentëve dhe ofrojnë shërbime për ta. E gjithë sipërfaqja e Universitetit Aldent shtrihet në një sipërfaqe jo më pak se 8600 m², ku zotërojnë salla leksionesh, klasa e laboratore, biblioteka dhe mjedise për rekreacion. Për studentët e Infermierisë dhe Fizioterapisë janë në dispozicion rreth 5000 m². Sallat e leksioneve kanë kapacitet deri në 120 studentë. Godina në dispozicion është 6 katëshe, ka 11 klasa për leksione, 4 klasa për seminare, 9 laboratore, biblioteka, ku mbi 3000 libra mund të shfrytëzohen nga studentët e Infermierisë dhe Fizioterapisë. Librat janë të sistemuara sipas profileve mjekësore dhe është bërë dhe informatizimi i literaturës. Ato janë të sistemuara sipas profileve mjekësore, me akses për të gjithë studentët. Biblioteka online Hinari funksionon ku studentët mund të gjejnë material ndihmës për detyrat e lëna nga pedagogët, për përgatitjen e detyrave të kursit, projektet etj. Në

çdo fillim viti akademik, stafi akademik përgatit nevojat sipas lëndëve e moduleve dhe bëhet porosia në mënyrë që literatura të jetë sa më afër studentëve. Labororet e Infermieristikës, Anatomisë, Fiziologjisë, Histologjisë dhe Anatomo-Patologjisë ofrojnë mundësi për të nxënë praktikën e duhur para se studentët të shkojnë në mjediset spitalore dhe ambulatorë. Të gjitha sallat e leksioneve janë të pajisura me video-projektor duke e bërë mësimin më lehtësisht të absorbueshëm dhe interaktiv gjithashtu. Klasat janë të mobiluara me karrige komode me tavoleta, dritaret janë të pajisura me grila, të cilat e lehtësojnë të parin e projektuar me videoprojektor. Ndriçimi natyral dhe artificial janë të orientura sipas nevojës. Laboratori i Informatikës ka 50 PC të ndara në tre salla. Të gjithë studentët kanë adresat e brendshme të emailit. Me qëllim aksesimin e të dhënave të tyre personale, rezultateve të tyre në provime, studentët mund të hyjnë në portalin e tyre, i cili është i aksesueshëm në faqen web ual.edu.al.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Mjediset për Programin e studimit
 - Salla për leksione
Janë 11 klasa në kampusin Qendror.
 - Klasa për seminare
Janë 4 klasa për seminare në Kampusin Qendror.
 - Salla për aktivitete promovuese
Janë 2 salla për aktivitete promovuese
 - Salla për praktikë lëndore/ profesionale
Janë 9 klasa për praktikë
 - Laboratorë informatike
Është 1 laborator informatike
 - Salla interneti
Ka një sallë interneti
 - Salla për bibliotekë
Ka një bibliotekë për t'u shfrytëzuar nga studentët e Infermierisë
 - Mjedis për fotokopjime, librari etj
Ka një mjedis të tillë të aksesueshëm nga studentët
 - Zyrë informacioni për studentët
Ka një zyrë informacioni për studentët
 - Nyje hidrosanitare
Janë 28 nyje hidrosanitare për studentët
- Mjediset për stafin:
 - Mjedise për Dekanin/ kancelarin
Janë tre zyra për dekan/Zvdekan/ kancelar
 - Zyra për sekretarinë mësimore
Janë 2 zyra për sekretarinë mësimore
 - Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
Janë 3 zyra për departamentet dhe qendrat kërkimore
 - Zyra për personelin akademik
Zyra për personelin akademik janë 6

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	

<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Institucioni ofron një literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore në gjuhë shqipe dhe të huaj. Biblioteka është mjaft e pasur me mbi 3000 tituj librash dhe periodikësh. Ato janë të sistemuara sipas profileve mjekësore, me akses për të gjithë studentët. Librat janë të klasifikuar sipas profilit dhe është bërë edhe informatizimi i literaturës. Në çdo fillim viti akademik, stafi akademik përgatit nevojat sipas moduleve dhe bëhet porosia në mënyrë që literatura të jetë sa më afër studentëve. Ka gjithmonë një buxhet të planifikuar për këtë zë. Revistat periodike po ashtu u japin mundësi studentëve të njihen me risitë shkencore në fushën e mjekësisë, duke përditësuar edhe të nxëniet e gjuhëve të huaja, sidomos asaj angleze e gjermane. Biblioteka shfrytëzohet duke përdorur vetëm librat që nuk dalin nga biblioteka, gjithashtu studentët mund të marrin edhe materiale për t'i studiuar në shtëpi. Kjo bëhet duke anëtarësuar studentët (ata kanë kartelat e tyre të bibliotekës). Gjithashtu funksionon Biblioteka online Hinari, në të cilën studentët mund gjejnë material ndihmës për detyrat e lëna nga pedagogët, për përgatitjen e detyrave të kursit, projekte etj. Megjithatë vërehet një interesim jo i madh i studentëve ndaj literaturës së huaj të ofruar nga Institucioni, pasi niveli jo i mirë i gjuhës angleze vështirëson shfrytëzimin e mjaftueshëm të saj.</p>
--	---

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>IAL ka salla leksionesh, klasa e laboratore, biblioteka dhe mjedise për rekreacion. Për studentët e Infermierisë dhe Fizoterapisë janë në dispozicion rreth 5000 m². Sallat e leksioneve kanë kapacitet deri në 120 studentë. Godina në dispozicion është 6 katëshe, ka 11 klasa për leksione, 4 klasa për seminare, 9 laboratore. Të gjitha sallat e leksioneve janë të pajisura me video-projektor duke e bërë mësimin më lehtësisht të absorbueshëm dhe interaktiv gjithashtu. Klasat janë të mobiluara me karrige komode me tavoleta, dritaret janë të pajisura me grila, të cilat e lehtësojnë të parin e projektuar me videoprojektor. Ndriçimi natyral dhe artificial janë të orientura sipas nevojës. Laboratori i Informatikës ka 50 PC të ndara në tre salla.</p> <p>Donim të theksonim rolin shumë të madh dhe të rëndësishëm të laboratoreve dhe atelieve, sidomos ato të Infermierisë, të cilët duke qenë të pajisura me mulazhe e manekinë, sigurojnë një praktikë profesionale të mirë, duke i aftësuar ata me principet bazë para se studentët të hyjnë në mjediset spitalore dhe shëndetësore të tjera. Ata mund të manipulojnë aty duke punuar në grupe me 10-12 studentë. Ekzistojnë marrëveshje me Institucione të shërbimit parësor dhe universitar, të cilat na u vunë në dispozicion.</p>
--	--

Konkluzione të GVJ:

Mjediset e Universitetit duket qartë se janë në funksion të shërbimit ndaj studentëve dhe ofrojnë shërbime për ta, duke lehtësuar integritetin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Atelietë dhe laboratorët e UAL janë mirë të pajisura, një investim i mirë dhe i orientuar drejt, në shërbim të studentëve dhe pedagogëve. Mjediset janë me sistem ajrosjeje dhe kondicionimi. Institucioni ofron një literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore në gjuhë shqipe dhe të huaj. Biblioteka me larmi titujsh, periodikësh mundëson studentët të shtojnë njohuritë e tyre dhe t'i ndajnë ato. Gjithashtu funksionon biblioteka online Hinari, në të cilën studentët mund të gjejnë material ndihmës për përgatitjen e detyrave të kursit, projektet kërkimore shkencore, përgatitjen e tezave të diplomës etj. Megjithatë vlen të vihet në dukje se ka një shfrytëzim jo të mjaftueshëm të literaturës së huaj, për shkak të vështirësive të lidhura me njohjen në një nivel jo të mirë të gjuhës angleze. Praktikave profesionale kryhen me lehtësi dhe me profesionalizëm, falë mjediseve dhe pajisjeve që ofron Institucioni. Gjithashtu ekzistojnë marrëveshjet me Institucionet shëndetësore shqiptare, të cilat lejojnë praktikimin e studentëve.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Universiteti Aldent është një Institucion privat i Arsimit të Lartë dhe si i tillë ai financohet nga burimet e tij të brendshme të financimit (tarifat e studentëve). Numri i studentëve ka ardhur në rritje, në përputhje me shtimin e burimeve njerëzore (staf akademik dhe ndihmës akademik si edhe staf administrativ), por në përputhje me gjithçka kushtet e mësimnxënies dhe aftësimit për studentët kanë ardhur duke u përmirësuar. Kostoja për student gjatë vitit akademik 2015-2016 ka qenë 1768890 lekë.

Fondet e pasura në dispozicion në UAL (falë menaxhimit të mirë të tyre nga autoritetet drejtuese) janë vënë në përdorim për shtimin e infrastrukturës në dispozicion të studentëve si laboratore, auditore, biblioteka, atelie studentësh, blerje kompjuterash etj. Dyfishimi i sipërfaqes për student nga 4m²/student në 8 m²/ student, u realizua në vitin 2014 dhe përbën një hop në shërbim të cilësisë në të gjitha drejtimet. Është rritur numri i stafit akademik me grada e tituj, duke punësuar sipas procedurave të sakta dhe standarde të punësimit. Vetëm në fillim të vitit akademik 2014-2015 janë punësuar 7 pedagogë. Studentët nuk paguajnë tarifa shtesë për provimet apo për përsëritjen e vitit akademik (për një vit). Po kështu ata nuk paguajnë për marrjen e vërtetimeve, transportin e tyre për dhe nga Universiteti. Studentëve u ofrohen nga IAL aktivitete brenda dhe jashtë territorit të institucionit, përfshirë edhe seminare trajnuese dhe informuese. Një pjesë e studentëve kanë marrë pjesë në aktivitete si Summer School apo Winter School.

Universiteti Aldent është një institucion, i cili ka ofruar donacione me karakter humanitar, duke sponsorizuar në rikonstruksionin e pavionit të Fizioterapisë në QSUT, apo rikonstruksionin i çerdhes nr.23 në varësi të Bashkisë së Tiranës, apo përfshirja në donacione me rastin e fatkeqësive natyrore apo në dobi të fëmijëve jetimë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Tarifat për dhe gjatë shkollimit

Tarifat kanë ardhur në rritje nga viti i parë i çeljes deri sot, kur gjatë vitit 2015 ato kanë qenë 317 815 533 lekë.

- Sponsorizimet

Nuk ka të dhëna në shifra monetare Universiteti Aldent është një institucion, i cili ka ofruar donacione me karakter humanitar, duke sponsorizuar në rikonstruksionin e pavionit të Fizioterapisë në QSUT, apo rikonstruksionin e çerdhes nr.23 në varësi të Bashkisë së Tiranës, apo përfshirja në donacione me rastin e fatkeqësive natyrore apo në dobi të fëmijëve jetimë.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Kosto e studimit për student gjatë viti 2015 ka qenë 178 890 lekë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij; Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj; Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Nisur edhe nga të dhënat e RVB, ne konstatuam se ky institucion ka bërë vazhdimisht auditim të jashtëm dhe të brendshëm (dokumentet u vunë në dispozicionin tonë). Ka kontrata të nënshkruara me personelin, lista e shpenzimeve operative, kontrata blerje librash dhe mjetesish didaktike, të gjitha në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Pagesat e studentëve janë konform rregullave nëpërmjet sistemit bankar.

VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR

Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;

Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;

Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

Institucioni ka një stabilitet financiar, kjo falë kryesisht menaxhimit të mirë të të ardhurave hyrëse. Investimet e kanë justifikuar ecurinë e mirë në drejtim të cilësisë. Institucioni nëpërmjet një bilanci të kujdesshëm deklaron në mënyrë të hollësishme tarifat hyrëse, ndarjen sipas zërave të buxhetit dhe në vite kalendarike vihet re shtimi i shpenzimeve, kostos për student, por edhe shtimi i pagave. Sigurisht të ardhurat kanë qenë në rritje, pasojë e një rekrutimi të mirë dhe të justifikuar të studentëve. Raportet e detajuara në zëra të buxhetit janë paraqitur edhe grafikisht dhe na u vunë në dispozicion.

Konkluzione të GVJ:

Nga të gjitha konstatimet, si të shkruara ashtu edhe të verifikuara mund të themi që ky është një institucion i mirëdizenjuar, që po rritet në cilësi dhe performancë. Ky institucion menaxhon mirë të ardhurat e veta, ka qëndrueshmëri financiare, nuk ka detyrime ndaj të tretëve. Bën vazhdimisht auditim të jashtëm dhe të brendshëm dhe shfaq e dokumenton pasqyrat financiare të parashikuara në legjislacionin tatimor.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Institucionet e Arsimit të Lartë sipas ligjit të arsimit Nr. 9741, datë 21.05.2007 janë përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe ngrenë njësinë përkatëse të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Universiteti Aldent duke pasur si mision të tij të qenit një nga universitetet më cilësore në vend dhe rajon, e konsideron menaxhimin dhe vlerësimin e cilësisë si një nga faktorët kryesorë për të realizuar synimet e tij. Sistemi i menaxhimit të brendshëm të cilësisë konsiston në një strukturë, e cila është vazhdimisht në përmirësim e sipër dhe në përshtatje me objektivat dhe nevojat e institucionit. UAL punon me përkushtim për të implementuar kërkesat e Standardit të Cilësisë. Për këtë qëllim UAL ka vënë në dispozicion burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore, duke forcuar dhe trajnuar veçanërisht Departamentin e Vlerësimit dhe Menaxhimit të Cilësisë. Njësia e SBC ka si objekt mënyrën se si një institucion kryen proceset dhe aktivitetet e tij me qëllim arritjen e besueshmërisë në mënyrë të vazhdueshme dhe konstante në drejtim të shërbimeve apo produkteve që plotësojnë kërkesat e cilësisë së klientëve të saj (studentët, prindërit, universitetet partnere, bizneset, etj.) si dhe kërkesat e aplikueshme rregullatore (Ligji i Arsimit të Lartë, Udhëzimet e MASH, Kriteret dhe Rregullat e Akreditimit Kombëtar apo Ndërkombëtar, etj.).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- Sa anketime kanë bërë me studentët

Nga kontaktet që patëm me studentët dhe pedagogët e këtij fakulteti, për të bërë një vlerësim të rregullt dhe periodik të kënaqësisë së studentëve janë kryer anketime 1 herë në vit, që janë bazuar në hartimin e pyetësorëve dhe plotësimin e tyre me shkrim ose në rrugë elektronike. Këto pyetësorë synojnë në përmirësimin e proceseve mësimdhënëse dhe nxitin angazhimin e stafit akademik për të qenë sa më afër studentëve dhe nevojave të tyre.

- Sa studentë janë anketuar

Numri i studentëve të anketuar është rritur nga viti në vit. 120 studentë janë anketuar gjatë vitit 2011-2012, 150 studentë gjatë vitit 2012-2013, 400 studentë gjatë vitit 2013-2014, 500 studentë në vitin 2014-2015 dhe 600 studentë në vitin 2015-2016.

- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë

Pyetësorët janë përpunuar dhe janë vlerësuar problematikat më të hasura, të cilat kanë qenë të lidhura me metodat e mësimdhënies për disa lëndë të vështira, me format e vlerësimit të studentëve, me disa probleme të lidhura me sistemin elektronik të sekretarisë, korrektësinë e pedagogëve në orarin e mësimi.

- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm

Janë marrë masa për përmirësimin e problematikave të hasura në lidhje me rishikimin e ngarkesës së pedagogëve, e cila ka ndikuar drejtpërdrejt në procesin mësimor dhe respektimin e orarit të mësimi prej tyre. Gjithashtu është instaluar dhe përmirësuar sistemi elektronik i sekretarisë dhe shërbimet e tij, janë bërë kontakte të drejtpërdrejta me pedagogët për të stimuluar formën interaktive të mësimdhënies dhe për të përmirësuar format e vlerësimit të studentëve.

- Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Njësia e Brendshme e Sigurimit të cilësisë monitoron vazhdimisht ruajtjen dhe rritjen e mëtejshme të cilësisë së brendshme të UAL, bazuar kjo në detyrimet që rrjedhin nga rregullorja e përgjithshme e këtij universiteti. Mbi bazën e kësaj NJSBC formaton objektin dhe kalendarin vjetor të kontrollit (planin vjetor të auditimit të brendshëm). Kontrolli mund të jetë i plotë, i cili përfshin gjithë veprimtarinë e subjektit objekt kontrolli dhe Kontrolli i orientuar, për aspekte të veçanta të veprimtarisë. Kontrolli ka karakter njerëzor dhe motivues. Ai bazohet në marrëdhënie mirëkuptimi midis të dy palëve duke vepruar me profesionalizëm dhe zbatuar kodin e sjelljes nga inspektorët.

Metodat mbi të cilat bazohet kontrolli janë: vëzhgimet, pyetësorët, intervistat, mbledhja e të dhënave dhe provave.

Me vendim nr. 12, datë 02.02. 2016 është vendosur ngritja e grupit të auditimit për vlerësimin e veprimtarisë së SBC në nivel institucional, të përbërë nga 3 pedagogë.

Në mbledhjen e senatit, në datën 19.03.2016 është vendosur miratimi i kriterëve specifike të standarteve të auditimit të strukturave të UAL.

Me urdhrin nr. 8, datë 14.04.2016 është miratuar lista e dokumenteve që duhet të kenë domosdoshmërisht strukturat institucionale: lista e dokumentacionit që duhet të ketë rektori, dekani i shkencave mjekësor/shërbimit, pedagogu kujdestar, zyra e burimeve njerëzore.

Në datën 21.04.2016 është miratuar plani i auditimit institucional për vitin akademik 2015-2016, referuar Statutit dhe Rregullores së Universitetit "Aldent".

Procesi i auditimit për dokumentacionet bazë si dhe plotësimin e kriterëve të standarteve të miratuara është kryer në njësitë e Universitetit "Aldent": Departamenti i Stomatologjisë, Qendra e Shërbimit klinik, Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike, Departamenti i Farmacisë, Departamenti i Infermierisë-Fizioterapisë, Departamenti i Laborantëve Dentare, Tutoriatet e të gjitha viteve akademike, Dekanatet, Zyra e Burimeve Njerëzore.

Dokumentacionet e paraqitura nga komisioni i auditimit na janë dhënë të plota në formë shkresore.

Në përfundim të këtij procesi auditimi të brendshëm institucional, komisioni i auditimit e vlerësoi maksimalisht punën e zhvilluar për implementimin e strukturuar dhe të formalizuar në rrugë shkresore të të gjithë procesit auditues duke dhënë dhe rekomandimet e nevojshme për masat që duhet të merren në drejtim të përmirësimit të procesit të punës.

Në fund të çdo viti akademik Njësia e SBC me informacionin e mbledhur nga të gjitha strukturat akademike dhe administrative të Institucionit harton një raport vjetor vetëvlerësimi.

- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Janë përcaktuar anëtarët e NJSBC, pozicioni që kanë në këtë njësi dhe eksperiencia e tyre në vite në NJSBC.

- Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Universiteti "Aldent", pas akreditimit të parë me urdher Nr. 240, datë 26.5.2011, me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore për akreditimin periodik, iu dha e drejta për fillimin e procesit të riakreditimit të programit Bsc. në "Infermieri e përgjithshme" nga APAAL, më 27.10. 2016 me shkresë Nr. 201/2 Prot.

Senati akademik me vendim Nr. 41 datë 31.10.2016 ngriti grupin e vlerësimit të brendshëm (GVB). Ky grup hartoi një raport, i cili paraqet një analizë të hollësishme për veprimtarinë e Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë në Universitetin "Aldent" si dhe një analizë të thellë e sistematike mbi vlerësimin e brendshëm të cilësisë së procesit mësimor të programit Bsc. në "Infermieri të përgjithshme". Në këtë raport vetëvlerësimi, GVB ka analizuar aktivitetin akademik dhe administrativ, duke evidentuar dhe pasqyruar arritjet, nevojat, si dhe problematikat e hasura në periudhën gati 6 vjeçare.

Ky raport, i cili është rezultat i kontributit të dhënë nga i gjithë stafi akademik dhe joakademik i Aldent, njësive administrative dhe ndihmëse, studentët dhe organizata e tyre studentore, u prezantua në Senat Akademik dhe u miratua prej tij.

Raporti i vlerësimit të brendshëm ka vlerësuar angazhimin e stafit akademik në realizimin me përpikmëri dhe cilësi të lartë të planit mësimor të miratuar, punën dhe ndihmën e pedagogëve të praktikave të studentëve, aktivitetin shkencor të realizuar nga stafi akademik, lidhjet e qëndrueshme dhe afatgjata me partnerët e institucioneve shëndetësore brenda vendit për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve, si dhe angazhimin e këtij Institucioni në krijimin e një infrastrukture komode dhe stimuluese në dispozicion të studentëve.

Gjithashtu, përveç arritjeve, ky raport paraqet dhe pikat e dobta të tij (inkurajimin më shumë të studentëve për përdorimin e librave të bibliotekës, rishikimin periodik të leksioneve, përpilimin e një programi më të qartë për kërkimin shkencor), mundësitë dhe pengesat, të cilat i ka paraqitur në RVB.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike janë identifikuar arritjet dhe problemet e identifikuar në Institucion, të cilat i janë komunikuar stafit për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së tyre.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta: Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj.</p> <p>Të drejtpërdrejta:</p> <p>Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Etj.</p>	<p>Universiteti Aldent ndjek në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e programeve të tij të studimit nëpërmjet instrumenteve matëse dhe vlerësuese, të cilat synojnë të përmirësojnë cilësinë e programeve të studimit, stafit akademik, administrativ dhe ndihmës, studentëve, proceseve të mësimdhënies, në përmirësimin e vazhdueshëm të leksioneve, seminareve, praktikave, shërbimeve të logistikës dhe shërbimeve të tjera.</p> <p>Institucioni përgatit një raport vjetor që vlerëson cilësinë në nivel të brendshëm dhe harton raportet publike duke bërë të njohur rezultatet e vlerësimeve që janë kryer dhe rekomandimet mbi ato çfarë duhet të punohet me tepër.</p> <p>Përdorimi i metodave të tërthorta dhe të drejtpërdrejta për kryerjen e vlerësimit nga NJSBC janë mjaft efikase.</p> <p>Metodat e tërthorta konsistojnë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sondazhet, ku studentëve iu bëhen anketime duke iu dhënë mundësi të shprehin ankesat apo sugjerimet e tyre, në kushte anonimat. - Shërbimi i Tutoriatit, i cili është një proces që ofrohet vetëm nga pedagogët tutor/ kujdestarët e grupeve të studentëve, të cilët nëpërmjet intervistimeve të vazhdueshme marrin informacione rreth vështirësive që ndesh studentit në përballimin e ngarkesës mësimore, ose aspekteve të ndryshme të procesit mësimor. <p>Metodat e drejtpërdrejta konsistojnë në:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - Takime të hapura që bën stafi akademik dhe administrativ i UAL, duke mundësuar që studentët të diskutojnë lirshëm rreth problemeve që lidhen me procesin mësimor. - Vlerësimi i studentëve. Shkalla e përvetësimit të dijeve bëhet me pikë dhe rezultati final konvertohet në notë, sipas formave të përcaktuara ligjore, pjesë e Statutit, Rregullores së përgjithshme dhe Programeve të studimit. - Testimet për vlerësimin e dijeve janë pjesë të dokumentacionit mësimor në formën e procesverbaleve. - Seminaret, detyrat e kursit, projektet, prezantimet me poëer point, metodat interaktive, etj janë pjesë e vlerësimit të vazhdueshëm të studentëve. - Mbikqyrja e studentëve gjatë praktikave profesionale nga pedagogët e lëndës.
VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Universiteti Aldent ka përmbushur standartet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional. Institucionet e arsimit të lartë sipas Ligjit të arsimit nr Nr.9741, datë 21.5.2007 janë përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe ngrenë njësinë përkatëse të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Universiteti Aldent që në vitin 2007-2008 ka filluar të punojë me përkushtim për të implementuar kërkesat e Standartit të Cilësisë. Sistemi i menaxhimit të brendshëm të cilësisë konsiston në një strukturë, e cila është vazhdimisht në përmirësim e sipër në përputhje me objektivat dhe nevojat e institucionit.</p> <p>Sigurimi i cilësisë shfrytëzon instrumente cilësore dhe sasiore për vlerësimin e cilësisë, ku disa prej tyre janë: diagrama e proceseve, grafikët, fletët e kontrollit, diagramat e kontrollit, diskutime në grup, krahasimi, analiza e pikave të forta, të dobta, mundësive dhe rreziqeve, etj.</p> <p>UAL dhe NJSBC synojnë në ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe studentëve mbi rëndësinë e cilësisë së programeve të studimit, të kuptojnë pikat e forta dhe të dobëta të tyre dhe të punojnë për të zhvilluar më tej pikat e forta dhe për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme zonat e dobësive.</p> <p>Njësia e SBC ka ngritur grupe pune të përvitshme për vlerësimin e veprimtarisë së SBC në nivel institucional. UAL në bashkëpunim me NJSBC ka hartuar, zbatuar dhe publikuar strategjitë që lidhen me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p>
<p>Konkluzione të GVJ: Universiteti Aldent, sipas Ligjit të arsimit nr Nr.9741, datë 21.5.2007 është përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe ka ngritur njësinë përkatëse të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Sigurimi i cilësisë është një proces i ndërgjegjshëm dhe i planifikuar që shfrytëzon instrumente cilësore dhe sasiore për vlerësimin e cilësisë. UAL në bashkëpunim me NJSBC ka hartuar, zbatuar dhe publikuar strategjitë që lidhen me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>Universiteti Aldent ndjek në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e programeve të tij të studimit dhe përdor metoda të tërthorta dhe të drejpërdrejta për të kryer vlerësimin e cilësisë së tyre.</p>	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Programet e studimit që ofron Fakulteti i Shkencave Mjekësore kanë objektiv formimin e profesionistëve të aftë në fushat përkatëse të studimit. Programet e studimit Bachelor synojnë të pajisin studentët me njohuri mbi disiplinat bazë, parime shkencore të përgjithshme dhe të nxitë tek ata formimin e shprehive profesionale. Studentët të diplomuar

në programin e studimit "Infermieri të përgjithshme" kanë formimin e duhur kulturor dhe profesional për t'u përfshirë me kompetenca të plota në aktivitete konkrete mjekësore, si në sektorin shtetëror dhe në atë privat.

Programi realizohet me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 3 vite akademike. Veprimtaria mësimore është organizuar sipas sistemit me 2 semestra, ku cdo semestër ka 15 javë mësimore. Lëndët shprehen në kredite ECTS ku një kredit përmban 25 orë mësimore. Krediti shpreh punën në auditor dhe jashtë auditorit që i duhet studentit për përvetësimin e lëndës. Në program janë parashikuar lëndët dhe kreditet përkatëse, shpërndarja e të cilave bëhet duke iu referuar udhëzimeve të vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Ndarja e aktiviteteve didaktike është kryer sipas udhëzimeve të MASH, në orë në auditor dhe orë studimi individual.

Në programin Bachelor në "Infermieri të përgjithshme" ofrohen Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, të cilat organizohen në 6 kategori (A-F), ku secila disiplinë ka lëndën ose grup lëndësh përkatëse të shprehura në kredite dhe ngarkesën në orë.

Praktikat profesionale të organizuara nga Departamenti nën mbikqyrjen e specialistëve të autorizuar kanë për qëllim ndjekjen nga ana e studentëve të pacientëve të ndryshëm dhe më pas përgatitjen e temave referuar rasteve, të cilat kanë pasur në shqyrtim. Pra studentët, në varësi të disiplinës do të kenë mundësinë e vlerësimit në të dy komponentët teorikë dhe praktikë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Me vendim Nr. 794 datë 22.07.2009 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Universitetit "Aldent" i është dhënë leje për hapjen e programit të studimit me kohë të plotë "Bachelor", në "Infermieri e përgjithshme". Duke synuar një program të standarteve të larta, Departamenti i Infermierisë ka pasur në qendër të vëmendjes përmirësimin e vazhdueshëm të planeve mësimore dhe përshtatjen e tyre me kërkesat në rritje të tregut të punës.

Qëllimi i programit Bachelor "Infermier i përgjithshëm" në "ALDENT" është përgatitja e studentëve me njohuri teorike dhe praktike të nevojshme për këtë disiplinë, si dhe pajisja e tyre me kompetenca bazë për studime të mëtejshme, specializime apo trajnime profesionale.

Objektivat e këtij programi studimi synojnë në formimin e profesionistëve të aftë të veprojnë në autonomi profesionale, të kuptojnë elementet bazë të proceseve patologjike, të njohin aspektin morfologjik dhe funksional të organeve dhe aparateve, etiologjinë e sëmundjeve kryesore, manifestimet klinike të hasura gjatë dekursit të sëmundjeve dhe trajtimin e tyre. Gjithashtu Formimin e profesionistëve të aftë të marrin pjesë në procesin e informimit, edukimit dhe mbështetjes së pacientit gjatë ndërhyrjeve diagnostiko - terapeutike e mediko - kirurgjikale si dhe aftësimin e studentëve për t'u përfshirë në aktivitete konkrete mjekësore dhe për t'u angazhuar në funksione të ndryshme në sektorin publik apo privat.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

Në Planet mësimore të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Në planet mësimore është përshkruar numri i krediteve për secilën lëndë dhe shpërndarjen e tyre sipas formave të mësimdhënies: leksione, seminare, laboratore, projekte/detyra, praktika.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit e zbatuara në plan

▪ Për leksionet	10 orë në auditor	dhe	15 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Seminaret	8 orë në auditor	dhe	17 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Laboraret	20-21 orë në auditor	dhe	5-4 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Praktikat lëndore	20 orë në auditor	dhe	5 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Praktikën Profesionale	20 orë në auditor	dhe	5 orë punë e pavarur e studentit
▪ Provimi përfundimtar	2 orë në auditor	dhe	23 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Nuk ka ndryshime në lidhje me kurrikulat e miratuara për programin studimor “Bachelor” në “Infermieri e Përgjithshme”. Ndryshimet e nevojshme bëhen me vendim senati akademik brenda kuadrit ligjor përkatës.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Në programin e studimit “Infermieri e përgjithshme” janë paraqitur dhe planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës, titullin/gradën apo kualifikimin përkatës, statusin si pedagog efektiv apo me kontratë. Shihet një përshtatje e lëndëve me pedagogët sipas specialitetit të tyre, e cila është një tregues mjaft i mirë për cilësinë e mësimdhënies.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Syllabuset e lëndëve përgatiten çdo fillim viti akademik nga pedagogët e lëndëve, i cili mbështetet në standartet kombëtare të cilësisë për arsimin e lartë. Nga vlerësimi i silabuseve për programin e studimit “Infermieri e përgjithshme” u evidentua një paraqitje në mënyrë të detajuar të elementëve të përmbajtjes. U vu re një punë e kujdesshme në përpilimin e tyre, ku elementet renditen sipas një kronologjie të caktuar, duke filluar me titullin e modulit, vitin akademik, semestrin kur zhvillohet lënda, kreditet dhe orët në auditor dhe jashtë auditorit, emrin e pedagogut përgjegjës për të, literaturën bazë bazuar në tekste dinjitoze, të hartuara nga specialistë të lëndëve me një informacion të përgjithshëm rreth saj, objektivat e lëndës dhe çfarë pritet që studenti të përfitojë në fund të saj, temat e trajtuara, format e mësimdhënies në leksione, seminare, ushtrime, praktika profesionale dhe raportet midis tyre, si dhe detyrimet e studentit për lëndën.

Megjithatë në paraqitjen e syllabuseve, temat e leksioneve nuk shoqërohen me numrin e orëve përkatëse në të cilat ato zhvillohen, gjë që mund të krijojë një papërputhshmëri të numrit të leksioneve të paraqitura me numrin e orëve të leksioneve, të vendosura në krye të syllabusit. Tematikat e përfshira në syllabuset sipas moduleve janë përgjithësisht të përshtatshme, megjithatë në module të vecanta si “Bioetikë dhe Legjislacion Mjekësor” është e nevojshme një përfshirje më e gjerë e temave specifike që i përkasin Etikës dhe Legjislacionit Mjekësor.

Dokumentacioni përkatës, i marrë në institucion.

Gjatë vizitës në Institucion ne patëm në dispozicion syllabuset e pedagogëve, të cilat u vlerësuan me vëmendje dhe dhamë rekomandimet e nevojshme në lidhje me to.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në	Programet e studimit të ofruara nga Institucioni janë hartuar sipas kërkesave të Sistemit të Bolonjës, duke

kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);
Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;

krijuar mundësinë për të marrë pjesë në Sistemin Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Në program përfshihen lëndët/modulet dhe kreditet përkatëse, shpërndarja e të cilave është bërë referuar rregullave dhe udhëzimeve të vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Lëndët shprehen në kredite ku një kredit përmban 25 orë mësimore.
 Ky program studimi ofrohet vetëm me kohë të plotë ku një student është i informuar mbi sasinë mesatare të krediteve që duhet të sigurojë gjatë një viti akademik, e cila është 60 kredite si dhe me kreditet sipas cdo lënde të zhvilluar gjatë ciklit 3 – vjeçar.

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.

Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;
Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;
Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;
Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

Programet e studimit të ciklit të parë zhvillohen sipas planit vjetor të miratuar nga Rektori i Universitetit, ku studenti merr informacionin e nevojshëm në lidhje me përmbajtjen e tyre nëpërmjet faqes së internetit të Fakultetit.
 Departamenti, si njësi bazë mësimore shkencore mbulon me mësimdhënie gjithë ngarkesën mësimore në përputhje me planin mësimor. Ai përpilon ngarkesën mësimore në fillim të cdo viti akademik duke plotësuar udhëzimin për ngarkesat e normuara.
 Në programin Bachelor në “Infermieri të përgjithshme” janë ofruar Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, të cilat organizohen në 6 kategori (A-F), ku secila disiplinë ka lëndën ose grup lëndësh përkatëse të shprehura në kredite dhe ngarkesën në orë. Në to janë pasqyruar lëndët e përfshira në secilën kategori, ku studenti informohet mbi karakterin e tyre, lëndë të formimit bazë, karakterizues, integruës, lëndë me zgjedhje, lëndë formuese plotësuese të detyruara.
 Departamenti orienton studentët e vitit të parë në lidhje me organizimin e mësimit, sekretarisë mësimore, orarin, vendndodhjen e sallave mësimore etj. Orari mësimor shpallet disa ditë para fillimit të semestrit. Puna mësimore zhvillohet në bazë grupi (seminaret), të cilat kanë jo më shumë se 20 studentë dhe kursi (leksionet) me 60 studentë.
 Syllabuset e lëndëve, të cilat përmbajnë në mënyrë të detajuar elementet e zhvillimit të procesit mësimor janë përpiluar nga pedagogët e lëndëve përkatëse në fillim të cdo viti akademik. Pedagogu iu paraqet studentëve para fillimit të modulit, përmbajtjen e syllabusit, objektivat, mënyrën e mësimdhënies, mënyrat e vlerësimit, frekuentimin etj, për të cilën na informuan dhe vetë studentët gjatë takimit që patëm me ta.

Konkluzionet e GVJ:

Programi i studimit “Infermieri e përgjithshme” i pajis studentët me njohuritë bazë duke synuar në formimin e duhur kulturor dhe profesional të tyre. Organizimi i disiplinave në kategori të veçanta dhe shpërndarja e tyre në vite duke filluar nga lëndët me formim të përgjithshëm dhe deri në konkretizimin profesional dhe praktik i shërben më së miri misionit të këtij programi. Veprimtaria mësimore në fushën përkatëse karakterizohet edhe nga veprimtaria kërkimore dhe krijuese ku studentët nxiten me përgatitjen e temave, eseve, detyrave të kursit etj.
 Disipinat përmbajnë lëndët dhe kreditet përkatëse, të cilat rishikohen në mënyrë periodike. Syllabuset e lëndëve, përmbajtja e të cilave mbështetet në standartet kombëtare të cilësisë për arsimin e lartë, përgatitet nga pedagogët në fillim të çdo viti akademik, ku studentët informohen mbi elementet e syllabusit nga pedagogët e tyre para fillimit të çdo moduli. Syllabuset ofrojnë tematikë përgjithësisht të përshtatshme në varësi të modulit, por rishikimi dhe përmirësimi i tyre është i nevojshëm, vecanërisht në modulën Bioetikë/Legjislacion Mjekësor për një përfshirje më të gjerë të temave specifike të Etikës dhe Legjislacionit Mjekësor. Temat e leksioneve nuk shoqërohen me numrin e orëve përkatëse në të cilat ato zhvillohen, e cila mund të krijojë një papërpunueshmëri të numrit të leksioneve të paraqitura në syllabus me numrin e orëve të leksioneve në auditor, të vendosura në krye të syllabusit.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Universiteti “Aldent” si një institucion arsimor dinjitoz, me objektiva të përcaktuara qartë synon në perfeksionimin e metodologjisë së mësimdhënies duke kërkuar modelet më të

përparuara bashkëkohore. Përshtatja dhe zbatimi i praktikave akademike më të përparuara, ndërthurra e teorisë me praktikën dhe teknologjisë me mësimdhënien janë objektivat kryesore për t'u ofruar studentëve mënyrën më të mirë të edukimit duke i aftësuar në tregun ndërkombëtar të punës. Universiteti "Aldent" synon të nxitë procesin aktiv të mësimdhënies duke përdorur metoda interaktive, të cilat kërkojnë përdorimin e mjeteve mbështetëse të teknologjisë së informacionit. Këto metoda perfeksionojnë konceptet bazë të mësuara, zgjerojnë njohuritë duke shfrytëzuar burime të ndryshme informacioni dhe zhvillojnë aftësitë shprehëse të studentëve. Gjithashtu puna në grup, e cila nxit aftësitë bashkëpunuese dhe shkëmbimin e eksperiencës si dhe aftësimi i studentëve për të bërë prezantime publike që në vitin e parë akademik janë teknika të tjera që aplikohen gjatë procesit të mësimdhënies. Laboratorët e Infermieristikës, të cilat krijojnë mundësi që studentët të praktikojnë të gjitha manipulimet infermierore në manekinët e dedikuara për këto procese dhe institucionet e tjera private ose publike, me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi mundësojnë praktikat profesionale të studentëve, të cilat mbikqyren nga departamenti dhe referentët e paracaktuar.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

- Leksione
- Seminare
- Ushtrime
- Laboratore
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale
- Etj

Në silabuset e lëndëve përkatëse janë përcaktuar në mënyrë të qartë format e mësimdhënies dhe raporti ndërmjet tyre.

Format e kontrollit të njohurive

Kontrulli i njohurive bëhet me anë të sistemit të vlerësimit me elemente të dyfishtë duke marrë në konsideratë të gjitha elementet që përfshihen në zhvillimin e lëndës, të tilla si: pjesa teorike e dhënë përmes leksioneve, seminareve, projekteve, kontrollit të pjesshëm të njohurive, etj. Kjo mënyrë i motivon ata që t'i kushtojnë rëndësinë e duhur të gjithë elementeve të vlerësimit. Duke u nisur nga kjo mënyrë vlerësimi, bazuar dhe në natyrën e disiplinës, kontrulli i dijeve realizohet nëpërmjet disa formave:

- Provimit me shkrim
- Provimit me gojë
- Vlerësimit të projektit
- Kombinimit të tre formave të mësipërme.

Llogaritja e notës përfundimtare për çdo student bëhet duke mbledhur pikët e aktivizimit gjatë orëve mësimore, laboratorëve/praktikave, kolokiumeve dhe provimit përfundimtar (aktivizimi, detyrat e kursit, seminarët, laboratorët, etj), referuar formularëve të vlerësimit të studentit sipas krediteve të çdo lënde, gjë e cila na u konfirmua edhe prej vetë studentëve gjatë takimit me ta. Totali i pikëve është 100 pikë për çdo lëndë sipas modeleve të formularëve. Rezultati i pikëve konvertohet në notë nga 4 (katër) në 10 (dhjetë). Të gjithë pedagogët përgjegjës të lëndëve apo moduleve, hartojnë tabelën (mënyren) e vlerësimit të studentëve, të cilën e depozitojnë dhe miratojnë në departament dhe njëkohësisht ua bëjnë të njohur studentëve në fillim të mësimit (ciklit të lëndës përkatëse).

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njesisë etj.

Studenti duhet të marrë pjesë dhe të vlerësohet për çdo komponent (aktivitet) të mësimdhënies:

pjesëmarrja në leksione është e detyruar mbi masën 75%,

pjesëmarrja në ushtrime/seminare është e detyruar mbi masen 75 %, pjesëmarrja në laboratore është e detyruar 100%; mungesat duhet të shlyhen para vlerësimit përfundimtar të lëndës/modulit.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi. Përcaktimi i kuotave të pranimit bëhet bazuar në standartet e miratuara dhe në përputhje me a) kapacitetet njerëzore dhe logjistike dhe planin e zhvillimit të tyre si dhe standartet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për infrastrukturën, stafin akademik efektiv, apo raportin pedagog/student. Ka një rritje të ndjeshme të numrit të studentëve të regjistruar në 2 vitet e fundit dhe një rritje graduale të numrit të pedagogëve efektivë. Në Universitetin Aldent është për t'u vlerësuar fakti që gjatë periudhës 2011-2017 ka një përmirësim të cilësisë së studentëve që ndjekin programin e studimit Bachelor në "Infermieri e përgjithshme", e cila është e dukshme në rezultatet e tyre në mbarim të studimeve. Nëpërmjet kontakteve që ruan Universiteti me ish të diplomuarit informohet mbi punësimin e tyre në përputhje ose jo me diplomën e marrë.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve
Kriteret e përgjithshme të pranimit të studentëve mbështeten në udhëzimet e MAS për pranimin e studentëve dhe transferimin, para fillimit të çdo viti akademik. Pranimi në ciklin e parë të studimeve është bërë në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore. Për pranimin e studentëve në vitin akademik 2016-2017 u ndoqën procedurat e rekrutimit në përputhje me Ligjin e Ri për Arsimin e Lartë në RSh.
- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve
Tek studentët në programin e studimit Bachelor "Infermieri e përgjithshme" gjatë periudhës 2011-2017 vihet re një rritje e notës mesatare në përfundim të ciklit 3 vjeçar (mbi 7.1) krahasuar me notën mesatare të hyrjes në këtë program studimi (mbi 6.5)
- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare
Numri total i studentëve të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë) gjatë periudhës 2011-2017 është 349. Ky numër ka pësuar një rritje të konsiderueshme në 2 vitet e fundit, 2015-2016 ku janë regjistruar 122 studentë dhe 2016-2017, me 111 studentë të regjistruar. Nota mesatare e pranimit të tyre gjatë periudhës 2011-2017 sipas viteve 2011-2012, 2012-2013, 2013-2014, 2014-2015, 2015-2016, 2016-2017, ka qenë përkatësisht 7.8, 7.49, 6.52, 6.85 dhe 7.2 gjatë dy viteve të fundit.
- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare
Numri total i studentëve të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse) gjatë periudhës 2011-2017 është 167, me notë mesatare që varion sipas viteve 2011-2012, 2012-2013, 2013-2014, 2014-2015, 2015-2016 përkatësisht 7.01, 7.63, 7.83, 7.31, 7.01.
- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend
Bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me rregullat e vendosura në kuadrin rregullator të brendshëm, institucioni ka pranuar regjistrimin e studentëve të transferuar nga institucione të tjera duke bërë të mundur njohjen e krediteve përkatëse. Në bazë të Rregullores së Brendshme dhe rregulloreve përkatëse të programeve, ngrihet komisioni për njohjen dhe transferimet e krediteve. Komisioni pasi vlerëson programet e paraqitura, përpilon një raport të detajuar me lëndët apo modulet, kreditet e të cilave mund të transferohen, si dhe me lëndët apo modulet, të cilat këta studentë duhet të frekuentojnë për të plotësuar programin.

Studenti që dëshiron të kryejë një pjesë të studimeve të këtij formimi në një Universitet tjetër, brenda ose jashtë vendit, në të njëjtën fushë, pajiset me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për këtë gjë, plane, programe mësimore dhe rezultatet e arritura.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Të dhënat për punësimin e studentëve merren nëpërmjet ruajtjes së lidhjes me ish të diplomuarit në Universitetin Aldent duke hapur një faqe në facebook, ku një pjesë e mirë e tyre janë punësuar në përputhje me diplomën, brenda vendit. Kanë filluar përpjekjet për hartimin e një database për grumbullimin e të dhënave nga ish –studentët e diplomuar në vite.

Numri total të diplomuarve

Numri total i të diplomuarve në programin e studimit “Infermieri e përgjithshme” është 167

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Numri total i të punësuarve, në përputhje me diplomën është 63, e cila është një tregues pozitiv për këta studentë.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Numri total i të punësuarve, jo në përputhje me diplomën është 44.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëprirjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Pranimi i studentëve në programin Bachelor në “Infermieri e përgjithshme” është kryer në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Per arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.407, datë 01.6.2016 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016-2017” si dhe kriteret të përcaktuar në vendimin Nr 9, datë 02.02.2016 të Senatit akademik të Universitetit “ALDENT”.</p>
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	

<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Studentët marrin informacion të plotë në lidhje me programin e studimit të ciklit të parë, misionin e tij, kohëzgjatjen e programit të studimit, mënyrën e organizimit të mësimit, kujdesin ndaj tyre në formën e tutoriatit, organizimin e praktikave infermiore, detyrimet e studentëve, respektimin e kodit etik të institucionit etj.</p> <p>Për një përmirësim të cilësisë së mësimdhënies, në fund të vitit akademik, Universiteti në bashkëpunim me NJSBC, harton një pyetësor anonim dhe konfidencial nëpërmjet të cilit studentët shprehin opinionet e tyre mbi punën e personelit akademik, sa përfitojnë gjatë shpjegimit dhe sa janë të kënaqur nga mënyra e organizimit të mësimit nga ana e pedagogut të lëndës.</p> <p>Studentëve iu ofrohet këshillim karriere, që realizohet nga këshillues profesionistë pranë Zyrës së Karrierës, qëllimi kryesor i së cilës është të ndihmojë studentët që vazhdojnë dhe përfundojnë studimet në UAL, për të arritur potencialin e tyre më të lartë të mundshëm dhe të jenë të mirëorientuar në tregun e punës. Zyra e karrierës i aftëson ata për intervista pune, zbulon strategji mbi mënyrën e të kërkuarit të punës, informon mbi mundësitë e punësimit të studentëve pas diplomimit të tyre, etj.</p>
<p>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Universiteti Aldent disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e ciklit të parë, të çregjistruar, transferimet, numrin e të diplomuarve, numrin e studentëve të larguar pa përfunduar vitin shkollor për arsye të justifikueshme. Sekretaria e Fakultetit pasqyron në regjistrin themeltar datën e shkëputjes së studentit.</p> <p>Universiteti disponon regjistrat e kursit, në të cilat pasqyrohet ecuria e tyre gjatë ciklit të parë të studimeve Bachelor në "Infermieri të përgjithshme" duke u pasqyruar vlerësimet për çdo komponent të mësimdhënies, pjesëmarrja në leksione, seminare, laboratore, aktivizimi dhe vlerësimet e dijeve të tyre. Gjithashtu disponon regjistrat fizikë dhe ata elektronikë të matrikulimit, notave, diplomave të studentëve.</p>
<p>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Zyra e Karrierës në Universitetin "Aldent" iu ofron studentëve këshillim karriere, e cila i ndihmon ata për të zhvilluar shprehitë vetjake, të përcaktojnë objektivat e karrierës, të identifikojnë mundësitë për karrierë në lidhje me diplomën që ata zotërojnë, të shkruajnë CV, etj.</p> <p>Zyra e Këshillimit të Karrierës organizon leksione të hapura apo seminare profesionale për informimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit pas diplomimit.</p> <p>Gjithashtu Shërbimi i Tutoritit që vepron në UAL bazohet në kujdestarinë për studentët, këshillim për përzgjedhjen e programeve të studimit dhe orientim për përfshirjen në tregun e punës.</p>
<p>Konkluzionet e GVJ</p> <p>Kuotat e pranimit të studentëve miratohen nga Senati Akademik bazuar në planin e zhvillimit të institucionit. Përcaktimi i kuotave të pranimit bëhet bazuar në standardet e miratuara dhe në përputhje me kapacitetet njerëzore dhe logjistike dhe planin e zhvillimit të tyre, standardet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për infrastrukturën, stafin akademik efektiv apo raportin pedagog/student. Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. Studentët e regjistruar në vitin e parë në Programin e studimit Bachelor në "Infermieri të përgjithshme" gjatë periudhës 2011-2017 janë me notë mesatare, e cila varion</p>	

nga 6.52-7.8.

Studentët marrin informacion të plotë në lidhje me programin e studimit, organizimin e tij, detyrimet e tyre dhe kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet opinioneve të tyre të pavarura. UAL disponon statistika dhe një dokumentacion të plotë dhe të saktë në lidhje me studentët që ndjekin programin e studimit të ciklit të parë. Regjistrat e kursit, regjistrat fizikë dhe elektronikë ruhen dhe arkivohen konform legjislacionit dhe akteve nënligjore në fuqi. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Shërbimi i Tutoriatit në Universitetin "Aldent" luajnë një rol të rëndësishëm në këshillimin e studentëve dhe aftësimin e tyre në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Kërkimi shkencor është një nga komponentet kryesore të aktiviteteve në Universitetin Aldent duke i dhënë këtij institucioni karakter mësimdhënës dhe kërkues. UAL ka përcaktuar dhe strategjitë në funksion të kërkimit shkencor, duke krijuar dhe bërthamat të cilat po transformohen në struktura të mirëfillta të kërkimit. Në këtë Universitet funksionon Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike dhe Qendra e Formimit të Shërbimit Klinik, në të cilin punojnë pedagogë me eksperiencë në fushën kërkimore shkencore. Në funksion të kërkimit shkencor janë edhe labororet të pajisura me aparatura bashkëkohore dhe si dhe materiale cilësore. Bazuar në Rregulloren e Universitetit "Aldent" punonjësit mësimorë shkencorë të Universitetit "Aldent" kanë të drejtën të kryejnë studime të plota pasuniversitare, kurse kualifikimi e specializimi në përputhje me planet e kualifikimit të miratuara në fakultete. Stafi akademik i Fakultetit të shkencave mjekësore është për t'u vlerësuar në drejtim të numrit të madh të botimeve, referimeve, posterave në kongrese dhe konferenca të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu vlen të përmendet dhe edhe puna që stafi akademik kryen me studentët duke i përfshirë ata në projekte të ndryshme kërkimore sipas fushave përkatëse, duke nxitur tek ata prezantimet publike, hartimin e temave të ndryshme, përgatitjen dinjitoze të temave të diplomës, etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor

Stafi akademik i UAL ka marrë pjesë në konferenca dhe kongrese ndërkombëtre brenda dhe jashtë vendit, ka realizuar një numër botimesh në revista shkencore ndërkombëtare dhe kombëtare, ka kryer një numër të konsiderueshëm referimesh dhe prezantimesh me postera në konferenca ndërkombëtare dhe kombëtare, ku mund të përmendim 220 referime dhe prezantime me poster, prej të cilave 142 në konferenca ndërkombëtare dhe 78 në konferenca kombëtare.

- Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

Në total, numri i botimeve të kryera nga personeli akademik është 95, ku 65 botime janë në revista shkencore ndërkombëtare (20 prej të cilave me faktor impakti) dhe 30 botime në revista shkencore kombëtare.

- Numri i projekteve kërkimore të fituara

Numri i projekteve të fituara është 2.

- Numri i projekteve të zbatuara

Stafi akademik Universitetit Aldent ka 2 projekte kërkimore të zbatuara.

- Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL

Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL është 16

- Dokumentacioni përkatës i marrë gjatë vizitave

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Universiteti Aldent ka si prioritet kryesor bashkëpunimin me institucionet homologe dhe ka hartuar një program me universitete, institucione të ndryshme, kompani prodhuese dhe organizata vendase dhe të huaja. Brenda një kohe të shkurtër ka arritur të vendosë marrëdhënie të ngushta me IAL-të në rajon mbi baza të shkëmbimit të programeve, stafit akademik, organizimin e konferencave të përbashkëta etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

- Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare

8 anëtarë të stafit akademik janë përfshirë në projekte ndërkombëtare, ku 3 prej tyre në projektin ndërkombëtar me Universitetin e Marmarasë, në kuadër të marrëveshjes së Kooperimit Bilateral midis Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit të Shqipërisë dhe Këshillit Turk të Shkencës dhe Teknologjisë Kërkimore; 3 anëtarë të tjerë të stafit akademik në projektin e realizuar në kuadrin e Programit të Kooperimit Bilateral Itali-Shqipëri 2012-2014; dhe 2 anëtarë të stafit akademik në projektin ndërkombëtar me Universitetin I Tor Vergates, Romë, Itali.

- Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj

Bazuar në raportin e vlerësimit të brendshëm, Universitetin Aldent e kanë vizituar dhe kanë dhënë kontributin e tyre në zhvillimin e leksioneve dhe trajnimeve të ndryshme dhe profesorë apo specialistë të fushave të ndryshme të mjekësisë nga Europa, Amerika dhe Azia. *Megjithatë nuk ka të dhëna konkrete për numrin e leksioneve dhe seminareve të kryera prej tyre.*

- Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL

Praktikat profesionale të studentëve dhe trajnimet e tyre organizohen në institucione private ose publike, me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi, si Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Spitali Universitar i Traumës, Materniteti "Koço Gliozheni" etj.

Studentëve iu është mundësuar punësimi gjatë sezonit veror në SHBA, kjo si rezultat i një prej aktiviteteve të organizuara nga Zyra e Këshillimit të Karrierës për prezantimin e projektit "Work & Travel USA 2017. Institucioni iu krijon kështu mundësi për t'u edukuar me disiplinën e punës dhe për të praktikuar gjuhën angleze.

Studentët kanë marrë pjesë në procesin e praktikave mësimore në kompaninë e njohur, LEK SAUDAS, Ljubljana, Slovenia; në aktivitetet shkencore, argëtimet dhe eventet sociale në MEDICAL SUMMER SCHOOL 3, në Dragan, Prizren, Kosovë dhe MEDICAL WINTER SCHOOL 3 në Ulqin, Budva, Mal i Zi.

- Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor

Në funksion të kërkimit shkencor, në organigramën e Universitetit Aldent përfshihet Qendra Kërkimore Farmakoterapeutike (QKF) për Fakultetin e Shkencave Mjekësore dhe Qendra Kërkimore e Shërbimit Klinik për Fakultetin e Shkencave Dentare, që kanë në dispozicion stafin dhe infrastrukturën për organizimin e aktiviteteve dhe programeve të kërkimit për këtë Institucion.

QKF- ja është e përbërë nga 4 laboratore: Laboratori i Kimisë së Përgjithshme, Inorganike, Organike; Laboratori Analiza e Drogave Bimore Mjekësore; Laboratori Analiza Farmaceutike dhe Kontrolli i Barnave; Laboratori i Përgatitjeve Galenike.

Qendra Kërkimore e Shërbimit Klinik ve në dispozicion të kërkimit shkencor 4 laboratore me standartet moderne dhe të pajisura me të gjitha aparaturat dhe mjetet konkretizuese të nevojshme.

Gjithashtu UAL posedon Laboratorin e Teknologjisë Informative me kompjutera personalë në shërbim të procesit mësimor dhe nevojave të veçanta të studentëve.

Në funksion të kërkimit shkencor, Institucioni ka vënë në dispozicion dhe një Bibliotekë të pasur me 3 mijë tituj librash të huaj.

- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime

50 anëtarë të stafit të brendshëm kanë qenë pjesë e aktiviteteve shkencore kombëtare dhe Ndërkombëtare.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:

- Institucionet qeveritare bashkëpunuese
- Organizatat Profesionale
- Komuniteti i biznesit, tregu i punës

Universiteti “Aldent” ka hartuar një program afatshkurtër dhe afatmesëm bashkëpunimi me universitete, institucione të ndryshme dhe firma të mëdha prodhuese vendase dhe të huaja.

Në bashkëpunimet kombëtare mund të përmendim:

- Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
- Spitalin Universitar të Traumës, Tiranë
- Maternitetin “ Koço Gliozheni”
- Universitetin e Mjekësisë për nxitjen e shkëmbimit të shumëanshëm në funksion të zhvillimit institucional

Në bashkëpunimet ndërkombëtare mund të përmendim:

- Universita degli studi “G. D’Annunzio Chieti, Pescara, për implementimin e projekteve kërkimore të përbashkëta në Itali.
- Qendrën Spitalore “San Giovanni XIII”, Monastier, Treviso në Itali, në fushën e kërkimit shkencor.
- Bashkëpunimi me Firmat e mirënjohura ndërkombëtare VITA-Gjermani, 3M-USA, etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Krijimi i një marrëdhënieje bashkëpunuese dhe ndarjeje eksperienceje midis anëtarëve të stafit ka qenë gjithmonë një objektiv i rëndësishëm për Universitetin “Aldent”. Nëpërmjet adresave të brendshme elektronike, çdo anëtar i stafit akademik informohet rreth aktiviteteve të ndryshme shkencore të organizuara brenda dhe jashtë vendit, artikujve në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, të rejat e fundit në fushat mjekësore, etj. Institucioni ka rregulloren e brendshme ku çdo anëtar i stafit i di mirë cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë e tij. Respektimi me rigorozitet i tyre ndihmon në shmangien e konflikteve mes anëtarëve të stafit duke krijuar një klimë bashkëpunimi të frytshme me njëri-tjetrin.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Në kuadër të bashkëpunimit kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun, në funksion të realizimit të objektivave në programet e studimit, Unversiteti Aldent ka arritur të vendosë marrëdhënie të ngushta me Institucione të Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Falë marrëveshjeve të bashkëpunimit me Institucione homologe publike dhe jo publike dhe institucioneve shëndetësore, stafit akademik i jepet mundësia të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme shkencore. Gjthashtu drejtuesit e Institucionit mbështetin financiarisht çdo anëtar të stafit akademik në projekte kërkimore brenda dhe jashtë vendit, gjë e cila rezultoi edhe në bisedat që ne bëmë gjatë kontaktit që patëm me stafin akademik.</p> <p>Në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë, Universiteti Aldent ka marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën Spitalore Universitare “ Nënë Tereza” , Maternitetin “Koco Gliozheni”, Spitalin Universitar të Traumës, etj, ku studentët e programit “Infermieri e përgjithshme” kryejnë praktikat, sipas planifimit të tyre nga departamenti.</p>

Konkluzionet e GVJ

Universiteti Aldent ka si prioritet kryesor bashkëpunimin me institucionet homologe dhe krijimin e partneriteve brenda dhe jashtë vendit. Në kuadër të bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar, stafi akademik i këtij universiteti është përfshirë në projekte ndërkombëtare, bashkëpunon me institucionet e huaja dhe vendase, studentët kryejnë praktikatat profesionale në ato institucione me të cilat Universiteti Aldent ka marrëveshje bashkëpunimi, etj. Cdo anëtar i stafit respekton rregulloren e këtij Institucioni dhe ruan një marrëdhënie korrekte dhe bashkëpunuese me kolegët. Universiteti Aldent inkurajon stafin akademik për një kualifikim të vazhdueshëm profesional duke i mbështetur ata në trajnime apo projekte kërkimore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit që ofron ky Universitet.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).**a. Pika të forta:**

1. Programi i studimit ofrohet nga një Institucion i konsoliduar me eksperiencë disa vjeçare dhe me profil tërësisht mjekësor.
2. Plani mësimor i programit të studimit është organizuar bazuar në praktikatat më të mira europiane dhe duke pasur parasysh specifikat kombëtare dhe kriteret për profesionet e rregulluara në vendin tonë.
3. Stafi akademik dhe ndihmës i angazhuar në procesin mësimor dhe praktikatat profesionale është i kualifikuar dhe ka eksperiencë në fushën e mjekësisë në përgjithësi si edhe infermieristikës në mënyrë specifike.
4. Infrastruktura komode dhe stimuluese për studentët, laboratorët të pajisur me aparatura moderne dhe materiale cilësore dhe praktikatat profesionale krijojnë mundësi që studentët të aftësohen dhe të fitojnë kompetenca profesionale.
5. Lidhje të qëndrueshme dhe afatgjata me partnerët e institucioneve shëndetësore shqiptare, të cilët lejojnë praktikimin e studentëve.
6. Perfeksionimi i metodologjisë së mësimdhënies duke kërkuar modelet më të përparuara bashkëkohore.
7. Implementimi i Sistemit të Menaxhimit të Brendshëm të Cilësisë në përshtatje me objektivat dhe nevojat e institucionit.

b. Pika të dobëta:

1. Shfrytëzimi i pamjaftueshëm i literaturës së huaj nga libraria online në dispozicion të studentëve për shkak të mosnjohjes në nivel të mirë të gjuhës angleze.
2. Pamundësia për mbulim të plotë të lëndëve dhe moduleve infermieristike me staf akademik me grada/tituj – Dr/Prof (kjo për shkak të mungesës së burimeve njerëzore në fushën akademike të infermieristikës në nivel kombëtar.)
3. Burime të pakta përfitimi me anë të projekteve apo shërbime ndaj të tretëve nga ana e personelit të stafit akademik.

c. Mundësitë:

- 1) Aplikime për projekte kombëtare dhe ndërkombëtare për financime në infrastrukturë në funksion të programit dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve.
- 2) Kërkesa e lartë për të diplomuarit në këtë program studimi, kryesisht jashtë vendit.

- 3) Bashkëpunime me intitucione të tjera, jo vetëm arsimore ndërkombëtare, për punësimin e studentëve të diplomuar.
- 4) Zhvillimi i politikave favorizuese nga ana e Qeverisë në drejtim të arsimit të lartë e veçanërisht drejt nxitjes së cilësisë në këtë fushë.
- 5) Iniciativa e Qeverisë për futjen e IAL private në skemën e financimit nga financat publike.
- 6) Rritja e kapaciteteve dhe eksperiencia e fituar, sjell rritje e zhvillim në mënyrë progresive të burimeve njerëzore dhe logjistike.
- 7) Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe partneritetet aktuale krijojnë siguri dhe premisa për partneritete të reja, zhvillimin e kërkimit shkencor, shkëmbim eksperiencë, shkëmbim stafi e studentësh dhe mundësi për pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare.
- 8) Përmirësimi i mëtejshëm i programit në përputhje me legjislacionin e ri të arsimit të lartë dhe zhvillimet e reja në fushën e mjekësisë.
- 9) Përmirësim të syllabuseve në drejtim të rishikimit dhe pasurimit të tematikave të moduleve, veçanërisht të modulit Bioetikë/Legjislacion Mjekësor, si dhe në drejtim të pasqyrimin saktë të orëve faktike në të cilat zhvillohet një temë e caktuar leksioni (të përputhshme me ato të vendosura në krye të syllabusit).
- 10) Asistencë ndaj stafit akademik për kualifikimin e vazhdueshëm brenda dhe jashtë vendit.

d. Pengesat:

1. Studentët e rinj që vijnë nga shkollat e mesme, pavarësisht rezultateve, kanë mangësi të njohurive të fushës së mjekësisë çka ndikon në disa raste në rritjen e nivelit akademik të mësimdhënies.
2. Mbështetja e ulët financiare dhe logjistike nga institucione shtetërore apo donatorë.
3. Procesi “Brain-Draining”, përfshi këtu pedagogët e rinj që synojnë institucione të huaja arsimore.

RESUME ANALYSIS OF EXTERIOR EVALUATION REPORT ACCORDING TO SWOT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS).

a. Strong points:

1. This study program is offered by a consolidated Institution with longstanding experience, its medical profile is of great worth in Albania for many years.
2. This educational study plan is being organised based on the best european practices , considering national specifics and the criteria for regulated professions in our country.
3. Academic and assistant staff involved in educational process and professional practices is very well qualified and posses experience in medical field in general and in nursing in particular.
4. The contemporary and stimulant infrastructure for the students, the well equipped laboratories (modern equipments and quality materials used) and professsional practices give the students the possibility to become capable and to gain professional competences.

5. There are sustained and life-long relations with partners of albanian sanitary institutions, who allow students to do practice.
6. Implementation of Internal Management Quality System in accordance to objectives and Institution's need.
7. The Improvement of teaching methodology, seeking the advanced contemporary models.

b. Weak points :

1. Lack of foreign medical literature's use from on line library (ready and dispoible to be used by the students) this is because of a poor knowledge of english language.
2. The impossibility for fully covering of all subjects and nursing modules of curricula, being lectured by academic staff having grades and tittles (Doctor and Professor), this because of human resources lack in academic field of nursing in national level.
3. A few profit resources obtained by projects or services to the third parties, from part of effective academic personnel.

c. Opportunities :

- 1) Applications for national and international projects, for financial aspects in infrastructure , to make the programme more functional and create the environment for the mobility of the personnel and the students.
- 2) High requirement for teh graduated students in this study programme , especially abroad.
- 3) Cooperation with other institutions , not only international educational ones, in order to create bridges for gradueted students employment.
- 4) Development of favourable politics by the Government directed to Higher Education and especially towards quality stimulation in this field.
- 5) Initiative of Government for involving Higher Education Institutions in finnacial scheme from public finances.
- 6) Capacities increase and obtained experience , could bring an augmentation and progressive development of human and logistic resources.
- 7) International collaboration and actual partnerities ensure safety and premises for new partnerities , development of scientific research , experience exchange , staff exchange and students exchange, possibilities for participation in international projects.
- 8) Future programme improvement in accordance to the New Legislation of Higher Education and to new developments in medical field.
- 9) Giving assistance towards academic staff for continuos qualification in and out of Albania .
- 10) Improvement of syllabi towards review and furnishing with new themes in modules, (i.e. module of Ethics/ Medical Legislation, explaining clear the factic hours , as the lecture is developed, in accordance to the frame of syllabus itself.

d. Threats :

1. Students of the first year, who come from high schools , nethertheless their good results obtained there, they have modest knowledge in medical field, so it is needed the increase of academic teaching.
2. Low financial and logistic support form state institutions and donations.
3. The process “Brain-Draining”,, including the young lectors who aim to enter the foreign educational institutions.

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:
Prof.Asc.Dr. Manika KREKA (FACE)

Dr. Brizida REFATLLARI (FURXHI)

ANEKSI 1

Tabela 1: Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK)

IAL	Fakulteti i shkencave mjekësore				Total
	Numri i PAE		Numri i PAK		
	Gjithsej	Tituj/ Grada	Gjithsej	Tituj/ Grada	
Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë	10	4	33	13	43

ANEKSI 2

Tabela 2: Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK)

Fakulteti i Shkencave Mjekësore						
Personeli i angazhuar në programin e studimit						
PAE (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	PAK (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada
Agim	Shehi	Dekan/Pedagog	Prof.As	Alma	Andoni	Spa